



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë më 22 prill 2024
Nr. ref.: AGJ 2425/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI38/23

Parashtrues

Flamur Dylhasi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 205/2022] të 10 tetorit
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Flamur Dylhasi, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: Parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimit [Rev. nr. 205/2022] e 10 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 1 nëntor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) si dhe nenin 10 të Deklaratës Universal për Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018 do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në postë, e cila në Gjykatë arriti dhe u regjistruar më 13 shkurt 2023.
8. Më 16 shkurt 2023, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR.KI38/23 caktoi gjyqtarin Enver Peci, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI38/23, emëroi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 28 shkurt 2023, Gjykata për regjistrimin e kërkesës, e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 28 mars 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës të shpallë kërkesën të pranueshme. Të njëjtë

datë Gjykata pas këshillimit dhe votimit, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, konstatoi shekeje të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës rezultojnë që parashtruesi i kërkesës më 30 qershor 2015 kishte lidhur kontratë pune [Nr. 8418/15] me Byronë Kosovare për Sigurime (në tekstin e mëtojme: BKS, për periudhë të caktuar kohore, përkatësisht prej 1 korriku 2015 deri me 30 qershor 2016, për pozitën Mjekë-Cenzorë, për vlerësimin e dëmeve jomateriale të cilat rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë.
13. Më 15 dhjetor 2015, Kryetari i këshillit administrativ i BKS-së kishte marrë vendim për zbritjen e pagave të punëtorëve për shkak të riorganizimit dhe implikimeve buxhetore.
14. Më 19 janar 2016, Këshilli administrativ i BKS-së mori Vendimin [nr. 172/16] për ndryshimin e kontratave të punës së punëtorëve, ndër të tjera, edhe kontratën e parashtruesit të kërkesës, si rrjedhojë e vendimit të lartcekur.
15. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar ta nënshkruajë ndryshimin e kontratës së punës për shkak të zbritjes së pagës.
16. Më 11 shkurtit 2016, BKS nxori Vendimin [Nr. 331/16] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.
17. Më 10 mars 2016, BKS nëpërmjet e-mailit e njoftoi parashtruesin e kërkesës për marrjen e Vendimit [Nr. 331/16] për shkëputje të marrëdhënies së punës.
18. Më 21 mars 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë organeve të BSK-së, kundër Vendimit [Nr. 331/16] të 11 shkurtit 2016, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit të Punës dhe pamundësisë për t'u deklaruar në lidhje me të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës. Parashtruesi i kërkesës thekson se në lidhje me ankesën e parashtruar nuk mori asnjëherë përgjigje nga BKS-ja.
19. Më 4 maj 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Vendimit [Nr. 331/16] të 11 shkurtit 2016 të BKS-së, nëpërmjet së cilës kërkoi anulimin e këtij vendimi dhe aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi, si dhe kompensimin e pagave nga 1 marsi 2016 deri më 30 qershor 2016.
20. Më 25 janar 2018, BKS në Gjykatën Themelore në Prishtinë dorëzoi përgjigje në kërkesëpadi, me të cilën, ndër të tjera, kërkoi edhe hedhjen poshtë si të pasafatshme të kërkesëpadisë për shkak të lëshimit të afatit 30 ditor, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatë.
21. Më 12 qershor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin [C. nr. 997/2016], (i) e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e anuloi si të kundërligjshëm Vendimin [Nr. 331/16] e 11 shkurtit 2016 të BKS-së, dhe (iii) e detyroi të njëjtën që në emër të dëmit material t'ia kompensojë shumën prej 3,508.80 euro, përfshirë kamatën ligjore në shumën prej 543.86 euro. Gjykata Themelore në aktgjykim konstatoi se vendimi i punëdhënësit ishte në kundërshtim me kontratën e punës dhe me dispozitat e neneve 70 dhe 71 të Ligjit të Punës. Ndër të tjera, Gjykata Themelore kishte konstatuar se mes palëve ndërgjyqese nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe se me vendimin e 15 dhjetorit 2015 të kryetarit të këshillit administrativ të BKS-ës, është vendosur të zbriten pagat për shumë pozita, ndër të tjera, edhe për pozitën e parashtruesit të kërkesës (paditësit),

duke i ofruar këtij fundit kontratë të re të punës. Tutje, në arsyetim theksohet se paditësi nuk ka pranuar ta nënshkruajë një kontratë të tillë, duke e kontestuar të njëjtën edhe pranë organeve të BKS-së, kjo e fundit mori vendimin kontestues me të cilin ia ndërprente parashtruesit të kërkesës marrëdhënien e punës, me arsyetimin se i njëjti e ka refuzuar vazhdimin e marrëdhënies së punës.

22. Në një datë të pasaktësuar, BKS-ja e apeloj Aktgjykimin e 12 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit me pretendimin se i njëjti ishte marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 7 shkurt 2022, Gjykata e Apelit, duke vendosur për ankesën e BKS-së, nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 4851/2017], nëpërmjet të cilit e refuzoi si të pathemeltë ankesën e BKS-së, dhe e konfirmoi Aktgjykimi e goditur me ankesë. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes së çështjes, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, të cilat arsye i ka papranuar edhe gjykata e shkallës së dytë.
24. Më 29 mars 2022, BKS parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimin të 7 shkurtit 2022 të Gjykatës së Apelit, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Nëpërmjet kërkesës për revizion, BKS kërkoi prishjen e aktgjytimeve të Gjykatës Themelore dhe të Apelit dhe aprovimin në tërësi të kërkesës për revizion.
25. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar përgjigje në revizion.
26. Më 10 tetor 2022, Gjykata Supreme, me Aktvendimin [Rev. nr. 205/2022], (i) aprovoi kërkesën për revizionin të BKS-së dhe hodhi poshtë si të pasafatshme kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, dhe (ii) prishi në tërësi aktgjykimet e instancave me të ulëta. Gjykata Supreme, në aktvendimin e saj arsyetoi se, gjykata e shkallës së parë në fakt ka vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, sepse në bazë të shkresave të lëndës, ishte i pakontestuar fakti se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Vendimin [Nr. 331/16] e 11 shkurtit 2016 të BKS-së më 10 mars 2016, i cili në udhëzimin juridik kishte përcaktuar se ndaj të njëjtit mund të ushtrohej e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh, pas marrjes vendimit të organit të BKS-së, gjersa parashtruesi i kërkesës ankesën e ka paraqitur më 21 mars 2016, dhe padinë në gjykatë e ka dorëzuar më 5 maj 2016, që nënkupton se padia është paraqitur pas afatit 30 ditorë në kuptim të nenit 79 të Ligjit të Punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me paragrafët 1 dhe 2 të nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, si dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
28. Parashtruesi i kërkesës me saktësisht pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk i përmbush standardet e një gjykimi të arsyetuar në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, nuk ka dhënë arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm lidhur me afatin e parashtrimin të padisë në gjykatë. Gjykata Supreme, sipas tij, nuk e ka sqaruar së prej cilës datë ka filluar të rrjedhë afati për paraqitjen e padisë dhe kur ka përfunduar ky afat. *“Gjykata, përkundër faktit që ka konstatuar se e*

paditura nuk ka vendosur lidhur me ankesën e paditësit, megjithatë nuk ka dhënë sqarime se brenda cilit afat e paditura është dashur të vendos për ankesën e paditësit, në mënyrë që të llogaritet se kur ka filluar të rrjedhë afati vijues ligjor prej 30 ditësh për paraqitjen e padisë në gjykatë, siç parashihet me nenin 79 lidhur me nenin 78 paragrafi 2 të Ligjit të Punës. Mbi këtë bazë parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme mbetet i paarsyetuar dhe i pasqaruar në çështjen e llogaritjes së afatit për parashtrimin e padisë në gjykatë, ndërsa duke mos e sqaruar dhe duke mos dhënë arsyetim se si ka ardhur deri te konstatimi i faktit se padia e paditësit është e pasafatshme, e i cili fakt ishte vendimtar në rastin e parashtruesit, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të Neni 31 (1,2) të Kushtetutës, sepse i ka mohuar parashtruesit, paditësit të drejtën e garantuar me Kushtetute për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm dhe për të pranuar një vendim të arsyetuar mirë, të qartë dhe të bazuar në ligj, e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj”.

29. Për me tepër parashtruesi i kërkesë pretendon se, Aktvendimi i Gjykatës Supreme është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuara me nenin 182, paragrafi 182.2 pika n) të LPK-së, lidhur me paragrafin 2 të nenit 78 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës, me çka ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, pasi që Aktvendimit të Gjykatës Supreme i mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare, arsyet e dhëna janë të paqarta, të pamjaftueshme dhe në kundërshtim me provat e paraqitura nga parashtruesi lidhur me afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë. Këto shkelje, thekson ai, kanë ndikuar që parashtruesit të kërkesës t'i cenohen të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me paragrafët 1 dhe 2 të nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së si dhe me nenin 10 të DUDNJ-së.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Parashtruesit, të garantuara me Nenin 31 (1,2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata Supreme e Kosovës, të të drejtave të garantuara për Parashtruesin me këto instrumente dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore; Të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.nr.205/2022 të datës 10.10.2022 të kundërshtuar me këtë Kërkesë dhe çështjen ta kthej në rivendosje në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës”.*

Dispozitat relevante

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
 - 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- [...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TE DREJTAT E NJERIUT

Neni 10
Çdokush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik, para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

LIGJI I PUNËS Nr. 03/L-212

Neni 78
Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit
1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.
2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të kërkesës.
3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Neni 79
Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë
Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

33. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

34. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ai konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 205/2022] të 10 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; i njëjti ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, ashtu siç parashihet me nenin 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, në pajtim me kërkesat e nenit 49 të Ligjit.
35. Megjithatë, përveç kësaj Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht në dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 34
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:

(...)

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të njaftueshme pretendimin e tij.”

36. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme GjEDNj) si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të analizës dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nënregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
37. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së, [Alimuçaj kundër Shqipërisë](#), nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih rastet e Gjykatës [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC*”, “*Alsi&Co. Kosovë LLC*” dhe “*BuildingConstruction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 64; [KI27/20](#), parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43, dhe së fundmi [KI82/22](#), parashtrues *Valon Loxhaj*, Aktgjykimi i 7 qershorit 2023, paragrafi 59).
38. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë pune me BKS-në, në kohë të caktuar, fillimisht nga 5 qershori 2012 deri më 30 qershor 2016. Në shkurt të vitit 2016, BKS kishte marrë Vendimin [Nr. 331/16], me të cilin parashtruesit të kërkesës i shkëputet kontrata e punës, për të cilin vendim i njëjti njoftohet më 10 mars 2016. Më të pranuar vendimin për shkëputje të kontratës, parashtruesi i kërkesës me 21 mars 2016 ishte ankuar pranë organeve të BKS-së, por në lidhje me këtë ankesë nuk kishte marrë përgjigje. Për pasojë i njëjti, më 4 maj 2016, kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore. Kjo e fundi e kishte aprovuar kërkesëpadinë tij dhe kishte anuluar Vendimin [Nr. 331/16] e BKS-së. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte apeluar në Gjykatën e Apelit nga BKS. Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së BKS-së e kishte refuzuar të njejtën, duke lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. E pakënaqur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, BKS kishte ushtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, e cila me Aktvendimin e kontestuar prishi aktgjykimet e goditura, duke konstatuar se kërkesëpadia ishte ushtruar jashtë afatit të paraparë me ligj.
40. Referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj-së dhe praktikës së saj, fillimisht Gjykata rikujton se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastet e Gjykatës [KI62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; paragrafi 41 dhe [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 38; shih gjithashtu Aktgjykimin i GjEDNj-së [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr.10590/83, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën

e vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'u përbahet këtyre parimeve.

41. Në këtë vazhde, Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe pretendimet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, vëren se thelbi i pretendimeve që ngërthen kjo kërkesë ndërlidhet me të drejtën për “qasje në gjykatë” si pjesë përbërëse e të drejtave të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.
42. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë e garantuar me dispozitat e lartcekura, dhe zbatimi i tyre është interpretuar gjerësisht nga GjEDNj-ja nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, dhe jo vetëm është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
43. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën për “qasje në gjykatë dhe drejtësi”, si një nga parimet themelore të një gjykimi të drejtë, në pajtim me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

i. Parimet e përgjithshme përkritazi me të drejtën për “qasje në gjykatë dhe drejtësi”

44. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se e drejta për të pasur “qasje në drejtësi” për qëllime të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së është qartësuar në rastin e GjEDNj-së [*Goldër kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), nr. 4451/70 Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36. Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GjEDNj-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në drejtësi” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së (shih, ndër të tjera, përkritazi me të drejtën për qasje në drejtësi, rastin e GjEDNj-së [*Zubac kundër Kroacisë*](#), nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GjEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime të tij/saj civile” para një gjykate kombëtare të themeluar me ligj (shih, në lidhje me këtë, rastin e GjEDNj-së [*Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të, si dhe rastin e Gjykatës [*KI214/21*](#), me parashtrues *Avni Kastratin*, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 2022, paragrafi 79).
45. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, përcakton që palët (ndërgjyqësit) duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GjEDNj-së [*Bëleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*](#), nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe [*Naït-Liman kundër Zvicrës*](#), nr.51357/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112, [*KI214/21*](#), cituar me lart, paragrafi 80).
46. Për me tepër, GjEDNj në rastin e lartcekur, [*Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#), (paragrafin 85), thekson se “kushdo mund të mbështetet në nenin 6.1 të KEDNj-së, kur konsideron se ka një ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e një prej të drejtave të tij ose të saj (civile) dhe ai ose ajo ankohet se nuk ka pasur mundësinë për ta paraqitur kërkesën e tij/saj në gjykatë, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNj-së. Kur ka një mosmarrëveshje serioze dhe të vërtetë për sa i përket ligjshmërisë së një ndërhyrjeje të tillë, neni 6.1 i jep të drejtë individit në fjalë që çështjet

e ligjit (ligjshmërisë) të vendosen nga një gjykatë vendore” (shih rastin e GjEDNJ-s; [Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 29392/95, Aktgjykimi i 10 majit 2001, paragrafi 92; shih gjithashtu rastin [Markovic dhe të tjerët kundër Italisë](#), [DhM], nr. 1398/03, Aktgjykimi i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 98).

47. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me “të drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GjEDNJ-së [Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.
48. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti duhet të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNJ-së [Le Compte, Van Leuwen and De Meyere kundër Belgjikës](#), nr. 6878/75, 7238/75, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; [Moreira de Azevedo kundër Portugalisë](#), nr. 11296/84, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; [Gorou kundër Greqisë \(nr.2\)](#), nr. 12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe [Boulois kundër Luksemburgut](#), nr. 37575/04, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). “Kontesti”, megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, duhet të jetë: (i) i “vërtetë dhe serioz” (shih, në këtë kontekst, rastet e GjEDNJ-së [Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë](#), Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe [Cipolletta kundër Italisë](#), Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë “vendimtare” për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së [Ulyanov kundër Ukrainës](#), nr. 16742/04, Vendimi i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, “lidhjet e paqëndrueshme” ose “pasojat e largëta” në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GjEDNJ-së [Lovrić kundër Kroacisë](#), nr. 38458/15, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51, dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të, dhe rastin e Gjykatës [KI214/21](#), cituar më lart, paragrafi 83).
49. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një “të drejtë civile” dhe një “kontest”, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, i garantojnë individit të drejtën “që çështja të zgjidhet nga një tribunal” (shih rastin e GjEDNJ-së [Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih rastin e GjEDNJ-së [Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës](#), nr. 5809/08, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).
50. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, Konventa nuk synon të garantojë të drejta që janë “teorike dhe të rreme”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive”, rastet e GjEDNJ-së [Kutić kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).

51. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih rastet e GjEDNj-së [Kutić kundër Kroacisë](#), nr. 48778/99, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 86 dhe referencat në të; [Acimović kundër Kroacisë](#), nr. 61237/00, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe [Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos](#), nr. 40786/98, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
52. Parimet e lartpërmendura, megjithatë, nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së. Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në masën sa të kufizojnë qasjen e individit duke cenuar vetë thelbin e të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së [Baka kundër Hungarisë](#), nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim” dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GjEDNj-së [Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 8225/78, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 89; [Nait-Liman kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafi 115; [Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 17101/03, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe [Marković dhe të tjerët kundër Italisë](#), nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99; dhe rastin e Gjykatës [KI214/21](#), cituar më lart, paragrafi 87).

ii. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

53. Gjykata vëren se arsyeja kryesore për hedhjen poshtë të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës Supreme, nëpërmjet revizionit të ushtruar nga e paditura BSK-ja, ishte sepse kjo e fundit kishte konsideruar se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte dorëzuar pranë gjykatës së shkallës së parë jashtë afati prej 30 tridhjetë ditësh, sipas depozitave të Ligjit të punës, prandaj dhe nuk do duhej shqyrtuar meritat e saj.
54. Para se të hyje në analizën e rrethanave të këtij rasti konkret, Gjykata thekson se e drejta për qasje në gjykatë/drejtësi, në parim është e garantuar përkitazi me “kontestet” në lidhje me një “të drejtë civile”. Në këtë linjë, Gjykata vlerëson se për të përcaktuar aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy çështje esenciale, e para ndërlidhet me ekzistencën e një “kontesti” apo mosmarrëveshjeje reale, ndërsa e dyta që natyra e objektit të kontestit të bie në “të drejtën civile”.
55. Për sa i përket ekzistencës së një “kontesti”, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është në kontest me të paditurën BSK, përkitazi me një kontest pune, ku kishte kërkuar kompensim të pagave, si rezultat i shkëputjes së “jashtëligjshme” të kontratës së punës. Në këtë kuptim, ekzistenca e një kontesti mes parashtruesit të kërkesës dhe BSK-së, ka sjellë deri të inicimi i kërkesëpadisë në Gjykatën Themelore nga ana e parashtruesit të kërkesës.
56. Ndërsa, për sa i përket kriterit tjetër, nëse natyra e objektit të kontestit bie në “të drejtën civile”, Gjykata rikujton se objekti i kërkesëpadisë, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka ngritur në të vërtetë bie në kuadër të të drejtave civile. Thënë këtë, Gjykata konsideron

se në rastin konkret janë përmbushur të dyja kriteret për sa i përket çështjes nëse kemi të bëjmë me një “kontest” apo mosmarrëveshje të vërtetë dhe me të “drejta civile”, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

57. Gjykata Supreme, në aktvendimin e saj arsyetoi se, gjykata e shkallës së parë në fakt ka vendosur sipas kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, sepse në bazë të shkresave të lëndës, ishte i pakontestuar fakti se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Vendimin [Nr. 331/16] e 11 shkurtit 2016 të BKS-së më 10 mars 2016, i cili në udhëzimin juridik kishte përcaktuar se ndaj të njëjtit mund të ushtrohej e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh, pas marrjes vendimit të organit të BKS-së, gjersa parashtruesi i kërkesës ankesën e ka paraqitur më 21 mars 2016, dhe padinë në gjykatë e ka dorëzuar më 5 maj 2016, që nënkupton se padia është paraqitur pas afatit 30 ditorë në kuptim të nenit 79 të Ligjit të Punës.
58. Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës më 4 maj 2016 kishte ushtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, kundër Vendimit [Nr. 331/16] të 11 shkurtit 2016 të BSK-së, për shkëputjen e kontratës së punës. Gjykata Themelore me këtë rast kishte shqyrtuar meritat e kërkesëpadisë, dhe kishte vendosur të aprovojë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të anulojë si të kundërligjshëm Vendimin e cituar të BSK-së. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac.nr. 4851/2017] të 7 shkurtit 2022. Kundër këtij aktgjykimi e paditura BSK kishte ushtruar kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme, ku njeri nga pretendimet e saj, si palë e paditur ishte se kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës është dashur të hidhej poshtë nga gjykatat e instancës më të ulët si pasafatshme.
59. Në këtë kontest, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, dhe verën se kjo e fundit vendimmarrjen e saj e arsyetoi, si në vijim: *“...aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 391 paragrafi 1, pika t), nenit 182 paragrafi 2 pika e) të LPK-së, lidhur me nenin 79 të Ligjit të Punës, me çka ka ardhur edhe gjerë te zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale”*. Tutje, Gjykata Supreme, arsyetoi se *“Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika e) të LPK, qëndron për faktin se në këtë rast, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas padisë së ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj.”*. Duke theksuar tutje se, *“Nga shkresat e lëndës është i pa kontestuar fakti se paditësi vendimin me numër 331 të datës 11.02.2016, e ka pranuar me datë 10.03.2016 i cili vendim ka pas udhëzimin për mjetin juridik, ku është theksuar se: kundër këtij vendimi i punësuarit ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, pranë organeve kompetente të BKS-së... paditësi kundër këtij vendimi ka paraqitur ankesë me datë 21.03.2016. E paditura lidhur me ankesën e paditësit nuk ka vendosur. Paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur me datë 05.05.2016, që nënkupton se padia e paditësit në këtë rast është ushtruar pas afatit ligjor prej 30 ditëve”*.
60. Në anën tjetër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Gjykata Supreme, *“...nuk ka dhënë sqarime se brenda cilit afat e paditura është dashur të vendos për ankesën e paditësit, në mënyrë që të llogaritet se kur ka filluar të rrjedhë afati vijues ligjor prej 30 ditësh për paraqitjen e padisë në gjykatë, siç parashihet me nenin 79 lidhur me nenin 78 paragrafi 2 të Ligjit të Punës.*
61. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e kontestit, i referohet ligjit të aplikueshëm, respektivisht dispozitave të nenit 78 [Mbrotjtja e të drejtave për të punësuarit] dhe 79 [Mbrotjtja e të punësuarit në Gjykatë] të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, që përcaktojnë:

Neni 78

Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

1. *I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.*
2. *Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.*
3. *Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*

Neni 79

Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

62. Nga leximi i përmbajtjes së nenit 78, Gjykata vëren se ligjvënësi nëpërmjet dispozitave të këtij neni ka përcaktuar hapat procedural që i punësuarit duhet t'i ndërmarrë, paraprakisht tek punëdhënësi, para se të kërkojë mbrojtje gjyqësore të të drejtave në gjykatë. Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 78 të Ligjit të Punës në mënyrë shprehimore përcaktojnë afatet brenda të cilëve punëdhënësi duhet t'i përgjigjet të punësuarit, nëpërmjet një vendimi në formë të shkruar.
63. Ndërsa përmbajtja e nenit 79 të Ligjit të Punës, përcakton të drejtën e të punësuarit për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave në gjykatë, pasi që i punësuarit t'i ketë shterur të gjitha mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi i tij. Në këtë kontekst, neni 79 i Ligjit të Punës qartazi përcakton që nëse i punësuarit nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit, ose nuk ka pranuar përgjigje nga punëdhënësi i tij, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 78 të Ligjit të Punës, ai/ajo ka në dispozicion një afat shtesë prej tridhjetë (30) ditësh, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave në gjykatë, gjegjësisht për të parashtruar kërkesëpadi kundër akteve të punëdhënësit.
64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe verën se parashtruesi i kërkesës, më 10 mars 2016 ishte venë në dijeni të marrjes së Vendimit [Nr. 331/16] të 11 shkurtit 2016, nga ana e BSK-së. Pas kësaj date i njëjti, kundër vendimit në fjalë, me 21 mars 2016, kishte parashtruar ankesë pranë organeve të BSK-së. Kjo e fundit bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, do të duhej përgjigjur ankesës së parashtruesit të kërkesës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, respektivisht jo më vonë se 4 prilli 2016. Megjithatë brenda këtij afati pesëmbëdhjetë (15) ditësh, parashtruesi i kërkesës nuk kishte marr përgjigje nga BSK-ja. Për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e nenit 79 të Ligjit të punës, dispozitë kjo e cila shprehimisht përcakton se, nëse i punësuarit: "...nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.
65. Andaj, bazuar në kërkesat e nenit 79 të Ligjit të punës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës më 4 maj 2016 kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, që i bie në ditën e tridhjetë (30) kalendarike, pasi kishte kaluar afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, për të marr përgjigje për ankesën e ushtruar, më datë 21 mars 2016 pranë organeve të BSK-së, afat i cili ligjërisht do të përfundonte më 4 prill 2016. Nga kjo datë parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion të tij edhe tridhjetë (30) ditë afat shtesë, gjegjësisht deri me 4 maj 2016, për të parashtruar kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore, kundër vendimit të punëdhënësit, gjë të cilën e ka bërë në pajtueshmëri të plotë me afatet e përcaktuara me dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit

të punës, ligji ky i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, në bazë të të cilit vlerësohen kriteret e lejueshmërisë, përfshi afatshmërinë e një padie me natyrë civile.

66. Sa me sipër, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, i ndodhur para rrethanave faktike dhe juridike të këtilla, nuk priste që kërkesa e tij të paktën në aspektin formal-procedural do të hidhej poshtë si e pasafatshme nga ana e Gjykatës Supreme, meqë e njëjta kishte kaluar filtrat procedural në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se barra e përgjegjësisë në këtë rast rëndon mbi Gjykatën Supreme, e cila nuk i ka shqyrtuar me kujdesin e duhur shkresat e lëndës, kur ka bërë llogaritjen e afateve ligjore, siç janë përcaktuar me dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të punës. Për pasojë, duke i ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave me të ulëta, që ishin në favorin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme ia ka mohuar atij të drejtën për qasje në drejtësi dhe në zgjidhje efektive të kontestit.
67. Thënë këtë, Gjykata konstaton se Aktvendimi [Rev. nr. 205/2022] i 10 tetorit 2022 i Gjykatës Supreme, me të cilin është hedhur poshtë kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, si e pasafatshme, nuk i plotëson standardet e një gjykimi të drejtë, sipas kuptimit të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së. Për më tepër, Gjykata Supreme nuk ka ofruar arsye bindëse se përse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte e pasafatshme, dhe perse sipas saj, kishte kaluar afati prej tridhjetë (30) ditëve, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë.
68. Gjykata në lidhje me këtë çështje dhe bazuar në arsyetimin e dhënë në këtë Aktgjykim, pretë nga Gjykata Supreme që në procedurë të rivendosjes të eliminojë shkaqet të cilat kanë shkaktuar shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

Përfundime

69. Si përmbledhje, Gjykata, duke u bazuar në analizën e mësipërme, konkludon se Aktvendimi [Rev. nr. 205/2022] i 10 tetorit 2022 i Gjykatës Supreme, nuk është në pajtueshmëri me të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 dhe paragrafin 1 të nenit 116 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (1) d) dhe 48 (1) a) të Rregullores së punës, më 28 mars 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË SHPALLË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 205/2022] e 10 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme;
- IV. TË KTHEJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, çështjen në rivendosje në Gjykatën Supreme, në pajtim me këtë Aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës, deri më 28 tetor 2024, për masat e ndërmarra për zbatimin këtij Aktgjykimi;
- VI. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (5) të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

